

VENDIM
Nr. 81, datë 20.2.2019

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES SË GRANTIT NR.TF0A8666, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË
SIGURUARA NGA DHURUES TË NDRYSHËM, NËN FONDIN E BESIMIT
SHUMËDHURUES PËR MBËSHTETJEN PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR
ZBATIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR 2, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË
PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR 2**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes së grantit nr. TF0A8666, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën Fondin e Dytë të Besimit Shumëdhurues për Mbështetjen për Ngritjen e Kapaciteteve për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të IntegrUAR 2, për financimin e projektit për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integrUAR 2, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BANKA BOTËRORE
IBRD-IDA GRUP I BANKËS BOTËRORE

30 tetor 2018

Shkëlqesisë së Tij Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë
Republika e Shqipërisë

Në lidhje me: Shqipëri: Mbështetje për Ngritjen e Kapaciteteve për Zbatimin e Sistemit
të Planifikimit të IntegrUAR 2 (Granti nr. TF0A8666)

LETËRMARRËVESHJE

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të datës 2 nëntor 2015, të përgatitur në emër të Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”), kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), e cila vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm (“Dhuruesit”) në kuadër të *Fondit të Besimit Shumë-Dhurues për Mbështetjen për Ngritjen e Kapaciteteve për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të IntegrUAR 2*, propozon që t’i japë Marrësit një grant në një shumë, e cila nuk duhet të tejkalojë një milion e katërqind e pesëdhjetë mijë euro (euro 1,450,000) (“Granti”), sipas afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në këtë letër marrëveshje (“Marrëveshja”), e cila përfshin shtojcën bashkëlidhur, për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në shtojcë (“Projekti”).

Ky Grant financohet nga fondi i besimit i lartpërmendur për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga Dhuruesit. Në përputhje me seksionin 3.02 të kushteve standarde (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës Botërore për pagesat në lidhje me këtë Marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve që i janë vënë në dispozicion nga Dhuruesit për fondin e besimit të lartpërmendur dhe e drejta e Marrësit për të tërhequr të ardhurat nga Granti është në varësi të disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Marrësi paraqet, duke konfirmuar miratimin e tij më poshtë, se është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të realizojë Projektin në përputhje me afatet dhe kushtet e parashtruara ose të referuara në

këtë Marrëveshje.

1818 H Street NW ■ Washington, DC 20433 USA

Ju lutem konfirmoni miratimin e Marrësit për sa më sipër nëpërmjet nënshkrimit të një zyrtari të autorizuar nga Marrësi dhe shënimit të datës në kopjen bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje dhe kthimit të saj te Banka Botërore. Dispozitat e parashtruara në këtë letër marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi nga data në të cilën Marrësi njofton Bankën Botërore për plotësimin e procedurave të tij të brendshme.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

(Nënshkrim me emër, mbiemër)

Nga: _____

Maryam Salim

Menaxhere për Vendin

Zyra e Bankës Botërore, Tiranë

Republika e Shqipërisë

MIRATUAR:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri : ARBEN AHMETAJ
Titulli: MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Data 3 JANAR 2019

1. Kushtet standarde për grantet e realizuara nga Banka Botërore nga Fonde të Ndryshme, të datës 15 shkurt 2012.

2. Letër për Disbursim, me të njëjtën datë si kjo Marrëveshje, së bashku me “Udhëzimet e Disbursimit për Financimin e Projekteve të Investimeve”, të muajit shkurt 2017.

Granti nr. TF0A8666

SHTOJCË

Neni I

Kushtet standarde; përkufizimet

1.01. Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet e realizuara nga Banka Botërore nga Fonde të Ndryshme, të datës 15 shkurt 2012 (“Kushtet standarde”), me ndryshimet e parashtruara në seksionin 1 të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Përkufizimet. Përveç rasteve kur përmbajtja e kërkon ndryshe, termat e përdorur me shkronja të mëdha në këtë Marrëveshjeje kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet Standarde ose në këtë Marrëveshjeje dhe termat shtesë që vijojnë kanë kuptimet si më poshtë:

a) “GDFC” (DPFK) do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Marrësit të Financimit dhe Kontraktimit për Bashkimin Evropian, Bankën Botërore dhe Fondet e tjera të Dhuruesve ose çdo pasues i saj.

b) “MoFE” (MFE) do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë ose çdo pasues i saj.

c) “Kosto operative” do të thotë shpenzime operative progresive të kryera për llogari të koordinimit, zbatimit, dhe monitorimit e vlerësimit të Projektit, duke përfshirë gjithashtu pajisjet e zyrës, tarifat për marrjen me qira të zyrës, kostot e karburantit dhe të mirëmbajtjes së automjeteve, shpenzimet për takime dhe kostot e komunikimeve, por duke përjashtuar pagat e nëpunësve civilë të Marrësit dhe honoraret për të marrë pjesë në takime.

d) “Trajnim” do të thotë kosto të arsyeshme të: i) materialeve të trajnimit dhe marrjes me qira të ambienteve dhe pajisjeve të trajnimit; ii) tarifave për dhënie të leksioneve nga trajnuesit, udhëtimeve, akomodimit dhe *per diem* (dietave) të trajnuesve dhe të të trajnuarëve; dhe iii) çdo shpenzimi tjetër që lidhet me trajnimin (duke përfshirë turet studimore) që do të kryhen në kuadër të Projektit.

Neni II Zbatimi i Projektit

2.01 Objektivat dhe përshkrimi i Projektit. Qëllimi i Projektit është që të fuqizojë zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS), duke krijuar kushtet për të përfshirë një orientim performance në planifikimin e politikave dhe proceset buxhetore dhe duke përmirësuar kapacitetin institucional për të monitoruar rezultatet në nivelet e strategjisë dhe programit.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1 – Menaxhimi i sistemeve të informacionit

Mbështetja e investimeve në hartimin dhe zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (MIS) në fushat e menaxhimit financiar, asistencës së jashtme dhe planifikimit të integruar.

Pjesa 2 – Përmirësimi i planifikimit strategjik dhe politikave dhe ngritjes së kapaciteteve

Mbështetja e kapaciteteve për të përmirësuar koordinimin e dhuruesve, ngritjen e kapaciteteve për planifikimin, koordinimin, dhe monitorimin e vlerësimit të politikave IPS dhe rritjen e ndërgjegjësimit të MIS të zhvilluar në pjesën 1 të Projektit.

Pjesa 3 – Menaxhimi i Projektit

Mbështetja e menaxhimit të Projektit, duke përfshirë koordinimin dhe zbatimin, komunikimet, menaxhimin dhe auditimet financiare, prokurimin, monitorimin dhe vlerësimin dhe raportin e progresit, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të Drejtorisë së Marrësit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjëse për Koordinimin e Dhuruesve dhe GDFC-në në këtë fushë.

2.02 Zbatimi i Projektit në Përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Marrësi do të realizojë Projektin, nëpërmjet GDFC-së, në përputhje me dispozitat e: a) Nenit II të kushteve standarde; b) “Udhëzimeve për parandalimin dhe luftën ndaj mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-së”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011 dhe në 1 korrik 2016 (“Udhëzimet antikorrupsion”); dhe c) këtij neni II.

2.03 Vizibiliteti dhe vizita e dhuruesit. a) Marrësi, nëpërmjet GDFC-së, do të marrë ose do të organizojë marrjen e të gjitha masave që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e Dhuruesit për Projektin.

b) Për qëllime të seksionit 2.09 të kushteve standarde, Marrësi, nëpërmjet GDFC-së, me kërkesë të Bankës Botërore, do të marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e tij për t’u mundësuar përfaqësuesve të Dhuruesve që të vizitojnë çfarëdo sipërfaqe të territorit të Vendit Anëtar për qëllime që lidhen me Projektin.

2.04. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit. a) Marrësi, nëpërmjet GDFC-së, do të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e Projektit dhe do të përgatisë Projekt Raportet në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe në bazë të treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. Çdo Projekt Raport do të mbulojë periudhën e një (1) semestri/gjashtëmujori kalendarik dhe do t’i dorëzohet Bankës Botërore jo më vonë se një (1) muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Marrësi, nëpërmjet GDFC-së, do të përgatisë Raportin Përfundimtar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti Përfundimtar do t’i dorëzohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj (6) pas datës së mbylljes.

2.05. Menaxhimi financiar: a) Marrësi do të sigurojë se është mbajtur një sistem menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi, nëpërmjet GDFC-së, do të sigurojë që për Projektin, të përgatiten raporte financiare të pjesshme të paaudituar dhe t’i paraqiten Bankës Botërore si pjesë e Projekt Raportit jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, duke mbuluar tremujorin, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Marrësi do të kryejë auditimin e pasqyrave të tij financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 (b) të kushteve standarde. Çdo auditim i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën prej një (1) viti fiskal të Marrësit. Pasqyrat financiare të audituara për çdo periudhë të tillë do t’i jepen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.06. Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, shërbimet e jokonsulencës dhe shërbimet e konsulentëve të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Grantit, do të prokurohen në përputhje me kriteret e parashtruara ose të referuara në:

i. Seksionin 1 të “Udhëzimeve: prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës në kuadër të huave të IBRD-së dhe kreditimeve të IDA-s dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, janar 2011 (të rishikuar në korrik 2014) (“Rregulloret e prokurimit”), në rastin e mallrave dhe shërbimeve të

jokonsulencës.

ii. Seksionet I dhe IV të “Udhëzimeve: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në kuadër të huave të IBRD-së dhe kreditimeve të IDA-s dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të janar 2011 (të rishikuar në korrik 2014). (“Udhëzimet për konsulentët”) në rastin e shërbimeve të konsulentëve; dhe

iii. Dispozitat e këtij seksioni, pasi të përpunohen në planin e prokurimit të përgatitur dhe të përditësuar herë pas here nga Marrësi për Projektin në përputhje me paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.25 të udhëzimeve për konsulentët (“Plani i Prokurimit”).

b) Përkufizime. Termat me germa të mëdha që përdoren në paragrafët që vijojnë të këtij seksioni për të përshkruar metoda të posaçme prokurimi ose metoda shqyrtimi të kontratave të posaçme nga Banka Botërore, i referohen metodës korres-ponduese të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentit, sipas rastit.

c) Metoda të Posaçme të Prokurimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Jokonsulencës.

i) Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në nënparagrafin (“ii”) më poshtë, mallrat dhe shërbimet e jokonsulencës do të prokurohen sipas kontratave mbi bazën e Tenderimit Konkurses në nivel kombëtar, me Metodën e Tenderimit të Hapur, në bazë të procedurave shtesë që vijojnë:

A) Procedurat e “Tenderimit të hapur”, siç përcaktohet në ligjin për prokurimin publik të Shqipërisë, do të zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka Botërore.

B) Tenderuesit e huaj nuk do të pengohen nga tenderimi dhe asnjë preferencë e asnjë lloji nuk do t’i jepet ofertuesve në nivel kombëtar në procesin e tenderimit.

C) Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen që të tenderojnë nëse janë ligjrisht dhe financiarisht të pavarura dhe ushtrojnë veprimtarinë sipas ligjit tregtar të Marrësit.

D) Regjistrimi nuk do të shfrytëzohet për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve.

E) Ofertat do të hapen në publik në një vendodhje, menjëherë pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave në praninë e përfaqësuesve që zgjedhin të marrin pjesë.

F) Entet prokures do të shfrytëzojnë modelet e dokumenteve të tenderimit, siç janë miratuar nga Banka Botërore.

G) Në rastin e çmimeve të ofertës më të larta se vlerësimi zyrtar, të gjitha ofertat nuk do të refuzohen pa miratimin paraprak të Bankës Botërore.

H) Një procedurë me një zarf të vetëm do të përdoret për paraqitjen e ofertave.

I) Paskualifikimi do të kryhet vetëm për tenderuesin me vlerën më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet në kohën e hapjes së ofertës në bazë të kualifikimit.

J) Ofertuesit në formën e një “ndërmarrjeje të përbashkët” (bashkim operatorësh ekonomikë) do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe veçmas.

K) Përpara refuzimit të të gjitha ofertave dhe kërkimit të ofertave të reja, do të merret miratimi paraprak i Bankës Botërore.

L) Kontratat do t’i jepen ofertuesit me çmimin më të ulët, kryesisht përgjegjës, i cili është përcaktuar për t’u kualifikuar për të vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit të paracaktuara dhe të shpallura paraprakisht.

M) Negocimet pas tenderimit nuk do të lejohen me ofertuesin me çmim më të ulët apo me çdo ofertues tjetër.

N) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më shumë se 18 muaj) do të përmbajnë dispozitat për rregullimin e duhur të çmimit, të pranueshme për Bankën Botërore.

O) Garancitë e ofertës dhe të realizimit të kontratës do të jenë në formatin e përfshirë në dokumentet e tenderit të referuara në “F” më sipër. Garancia e Ofertës do të jetë e vlefshme për njëzet e tetë ditë (28) pas periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës ose pas çfarëdo periudhe shtyrjeje kohore, nëse kërkohet. Asnjë paradhënie nuk do të bëhet pa garanci të përshtatshme të paradhënies.

P) Dokumenti dhe kontrata e tenderimit, siç çmohet e pranueshme nga Banka Botërore, do të përfshijë dispozitat që përcaktojnë politikën e Bankës Botërore për të sanksionuar firmat ose individët, të zbuluar se janë përfshirë në mashtrim dhe korrupsion, siç përcaktohet në udhëzimet e prokurimit.

ii) Metodatat që vijojnë, përveç atyre të tenderimit konkurrues në nivel kombëtar, mund të shfrytëzohen për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të jokonsulencës për kontratat që janë të specifikuara në Planin e Prokurimit: A) Tenderimi ndërkombëtar i kufizuar; B) Tenderimi Konkurses në nivel kombëtar, në bazë të dispozitave shtesë që vijojnë;

C) Blerjet; D) Prokurimi sipas Marrëveshjeve Kuadër në përputhje me procedurat që janë vlerësuar të pranueshme për Bankën Botërore; E) Kontraktimi i drejtpërdrejtë; F) Pagesa për punën shtesë; G) Metoda prokurimi në sektorin privat të konsoliduar ose praktikatat tregtare që janë vlerësuar të pranueshme për

Bankën Botërore; dhe I) procedura për Pjesëmarrjen në Komunitet që janë vlerësuar të pranueshme për Bankën Botërore.

d) Metoda të Posaçme të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulentëve

i) Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në zërin “ii” më poshtë, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e Përzgjedhjes së Bazuar në Cilësi dhe Kosto.

ii) Metodatat që vijojnë, përveç Përzgjedhjes së bazuar në Cilësi dhe Kosto, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato emërime që specifikohen në Planin e Prokurimit: A) Përzgjedhje e bazuar në cilësi; B) Përzgjedhje me buxhet fikse; C) Përzgjedhje me Koston më të Ulët; D) Përzgjedhje bazuar në kualifikimet e konsulentëve; E) Përzgjedhje nga një burim i vetëm i firmave të konsulencës; F) Metoda prokurimi në sektorin privat të konsoliduar ose praktikant tregtare që janë vlerësuar të pranueshme për Bankën Botërore; G) Përzgjedhje e konsulentëve sipas kontratës së furnizimeve të papërcaktuara ose Marrëveshjes për çmimin; H) Përzgjedhje e konsulentëve individualë; dhe I) Procedura nga një burim i vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

e) Shqyrtimi nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit. Plani i Prokurimeve do të parashtrohet për ato kontrata që do t'i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Bankës Botërore. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen shqyrtimit të mëvonshëm nga Banka Botërore.

f) Mbajtja e dokumenteve. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 2(j) dhe 5 të shtojcës 1 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafëve 2 (k) dhe 5 të shtojcës 1 të udhëzimeve të konsulentëve, Marrësi: i) do të mbajë të gjitha dokumentet në lidhje me çdo kontratë, siç përshkruhet në paragrafët e përmendur për të paktën shtatë vjet e gjashtë muaj pas datës së mbylljes të parashtruar në seksionin 3.03 të kësaj Marrëveshjeje; ii) do t'i japë ato dokumente Bankës Botërore në çfarëdo kohë sipas kërkesës; dhe iii) me anë të kësaj autorizon Bankën Botërore për t'ia dhënë atë dokumentacion Dhuruesit.

Neni III

Tërheqja e të ardhurave të Grantit

3.01 Shpenzimet e pranueshme: a) Marrësi mund të tërheqë të ardhurat e Grantit në përputhje me dispozitat e: i) Kushteve standarde; ii) këtij seksioni; dhe iii) udhëzimeve të tilla shtesë që Banka Botërore mund të specifikojë, duke e njoftuar Marrësin (duke përfshirë “Udhëzimet e disbursimit për financimin e projekteve të investimeve”, të muajit shkurt 2017, të rishikuara herë pas here nga Banka Botërore dhe të bëra të zbatueshme në këtë Marrëveshje në zbatim të këtyre udhëzimeve), për të financuar shpenzimet e pranueshme sipas parashtrimit në tabelën në vijim. Tabela specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme, të cilat mund të financohen nga të ardhurat e Grantit (“Kategoria”), shpërndarjen e shumave të Grantit për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Pranueshme në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e grantit të alokuar (e shprehur në EURO)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallrat, shërbimet e jokonsulencës, shërbimet e konsulencës, kostot operative dhe trajnimi	1,450,000	100%
SHUMA TOTALE	1,450,000	

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera para datës së kësaj Marrëveshjeje.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e referuar në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 30 qershor 2019.

Neni IV

Përfaqësuesi i Marrësit; adresat

4.01 **Përfaqësuesi i Marrësit.** Përfaqësuesi i Marrësit i referuar në seksionin 7.02 të Kushteve Standarde është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

4.02 **Adresa e Marrësit.** Adresa e Marrësit e referuar në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë
Republika e Shqipërisë
Teleks: 0035542228405
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

4.03. **Adresa e Bankës Botërore.** Adresa e Bankës Botërore e referuar në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Teleks: Faks:
248423 (MCI) ose 1-202-477-6391
64145 (MCI)